

**SHOQERIA TREGTARE**  
**INFOSOFT SYSTEMS SH.P.K**  
**NUIS J61820021C**  
**Nr.Vendim Gjykate 13209, dt 27.12.1995**

**V E N D I M**  
**I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE**  
**TE SHOQERISE TREGTARE INFOSOFT SYSTEMS SH.P.K**  
**Nr. 321, Date 06.07.2022**

Sot me date 06.07.2022, Ortaket e Shoqerise InfoSoft Systems sh.p.k, shoqeri e formuar sipas ligjit shqiptar, e regjistruar me Nr.Vendimi 13209, dt 27.12.1995 te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, te njoftuar konform Statutit u mblodhen ne seline e Shoqerise prane Gjergji Center, Rr.Murat Toptani, Tirane:

1. **Shoqeria Investment Joti-InfoSoft Group sh.p.k**, e regjistruar me date 25.02.2009, ne Qendren Kombetare te Biznesit, Tirane dhe NUIS K91425022E, e perfaqesuar nga Znj.Eugena Agalliu, sipas autorizimit te leshuar me date 01.07.2022 nga Administratorja e Pergjithshme e Shoqerise Znj.Blerta Elezaj, e cila zoteron 70% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise.
2. **Shoqeria TAG Engineering sh.p.k**, e regjistruar me date 07.12.2017 ne Qendren Kombetare te Biznesit, me NUIS L72407008S, perfaqesuar nga Administratori i Pergjithshem Z. Armand Shara, e cila zoteron 20% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise.
3. **Z. Bledar Dhima**, shtetas shqiptar i cili zoteron 10% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise.

Megenesese plotesohet kuorumi i nevojshem, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre Vendime te vlefshme per ceshtjen ne rendin e dites:

1. Administratori i shoqerise Z.Armand Shara, prezantoi ceshtjen e rendit te dites duke vene ne dukje, nevojen e shoqerise per likuiditet. Si rrjedhim Administratori propozon zmadhimin e kapitalit te shoqerise.
2. Menyra e zmadhimit te kapitalit do te behet me kontribut ne para dhe me konkretisht, kreditimet e ortakeve per shoqerine Infosoft Systems sh.p.k, te sherbejne per rritje/zmadhim te kapitalit te shoqerise.
3. Vlerat e kredituara per secilin ortak jane:
  - Referuar Kontrates se Huase date 16.06.2022 te lidhur ndermjet paleve,Investment Joti-Infosoft Group sh.p.k, ne cilesine e Huadhenesit, ka kredituar shoqerine Infosoft Systems sh.p.k, me kredi ne vleren 392,400,000 Leke (treqind e nentehjete e dy milione e katerqind mije) dhe 1,163,900 Euro (nje milion e njeqind e gjashtedhjete e tre mije e nenteqind).
  - Referuar Kontrates se Huase date 01.01.2019, te lidhur ndermjet paleve,TAG Engineering sh.p.k, ne cilesine e Huadhenesit, ka kredituar shoqerine Infosoft Systems sh.p.k, me kredi ne vleren 112,114,286 Leke (njeqind e dymbedhjete milion e njeqind e katermbedhjete mije e dyqind e tetedhjete e gjashte) dhe 457,460 Euro



(katerqind e pesedhjetë e shtatë mijë e katerqind e gjashtedhjetë), ekuivalente me 54,405,714 Leke (pesedhjetë e kater milion e katerqind e pese mijë e shtatëqind e katermbedhjetë), me kursin e Bankes së Shqipërisë 1 euro-118.93 lek. Pra në total shoqëria TAG Engineering sh.p.k, ka kredituar vlerën prej 166,520,000 Leke (njëqind e gjashtedhjetë e gjashtë milion e pesëqind e njëzet mijë)

- Referuar Kontrates së Huasë date 01.01.2019 të lidhur ndërmjet paleve, Z.Bledar Dhima në cilësinë e Huadhenesit, ka kredituar shoqërinë Infosoft Systems sh.p.k, me kredi në vlerën 63,434,369 Leke (gjashtedhjetë e tre milion e katerqind e tridhjetë e kater mijë e treqind e gjashtedhjetë e nëntë) dhe 166,700 Euro (njëqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind) ekuivalente me 19,825,631 Leke (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e njëzetë e pese mijë e gjashtëqind e tridhjetë e një), me kursin e Bankes së Shqipërisë 1 euro-118.93 lek. Pra në total, Z.Bledar Dhima ka kredituar vlerën prej 83,260,000.00 Leke (tetëdhjetë e tre milion e dyqind e gjashtedhjetë mijë).

Pas një diskutimi mbi çështjet në rendin e ditës dhe duke mos patur çështje të tjera jashtë rendit të ditës për të diskutuar, Asambleja e Ortakëve me unanimitet,

#### VENDOSI:

1. Të miratojë zmadhimin e kapitalit me kontribut në para, konkretisht nëpërmjet vlerave të kredituara nga Ortaket në shoqërinë Infosoft Systems sh.p.k. Zmadhimi do të bëhet nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të kuotes, sipas vlerave të shprehura në Tabelën 1. Vlera e zmadhimit të shprehur në leke është **532,600,000 Leke (pesëqind e tridhjetë e dy milion e gjashtëqind mijë):**

**Tabela 1: Vlera e kontributit monetar shtesë**

Ortakët	Totali (leke)
Investment Joti-Infosoft Group shpk	282,820,000
TAG Engineering	166,520,000
Bledar Dhima	83,260,000
<b>TOTAL</b>	<b>532,600,000 leke</b>

2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, kapitali i shoqërisë Infosoft Systems sh.p.k. nga 67,400,000 (gjashtedhjetë e shtatë milion e katerqind mijë) Leke, bëhet 600,000,000 Leke (gjashtëqind milion), sipas Tabeles 2 me poshtë:

**Tabela 2: Ndryshimi i kapitalit themeltar para dhe pas zmadhimit**

Ortakët	Shuma e kapitalit aktual (leke)	Kontributi në para shtesë (leke)	Vlera e kapitalit të ri (leke)	Pjesëmarrja në kapital
Investment Joti-Infosoft Group sh.p.k	47,180,000	282,820,000	330,000,000	55%



TAG Engineering sh.p.k	13,480,000	166,520,000	180,000,000	30%
Bledar Dhima	6,740,000	83,260,000	90,000,000	15%
<b>TOTAL</b>	<b>67,400,000</b>	<b>532,600,000</b>	<b>600,000,000</b>	<b>100%</b>

3. Per shkak te zmadhimit te kapitalit dhe kontributit te secilit ortak ne kapitalin themeltar, ndryshon edhe pjesmarrja e tyre ne kapital konkretisht, gjendja pas zmadhimit te pjesmarrjes ne kapital eshte:

**Tabela 3: Tabela e pjesmarrjes ne kapital**

Ortakët	Vlera e kapitalit te ri	Pjesmarrja ne kapital
Investment Joti-Infsoft Group sh.p.k	330,000,000	55%
TAG Engineering sh.p.k	180,000,000	30%
Bledar Dhima	90,000,000	15%
<b>TOTAL</b>	<b>600,000,000</b>	<b>100%</b>

4. Autorizohet Z.Armand Shara, ne cilesine e Administratorit te Pergjithshem te Shoqerise, qe ne emer dhe per llogari te Shoqerise Infsoft Systems sh.p.k. te nenshkruaje anekset/amendamentet e saj ne lidhje me zgjidhjen e kontratave te huase te sipercituara, si dhe te nenshkruaje cdo akt ne zbatim te ketij Vendimi.

Meqenese nuk kishte me ceshtje te tjera jashte rendit te dites per te diskutuar, mbledhja u deklarua e mbyllur.

#### ORTAKET

**Investment Joti-Infsoft Group sh.p.k.**

**Eugena AGALLIU**  
Perfaqesuese e Autorizuar



**TAG Engineering sh.p.k.**

**Armand SHARA**  
Administrator i Pergjithshem



**Bledar DHIMA**

BLEDAR DHIMA

